

URDHËR
Nr. 287, datë 6.7.2012

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË STUDIMIT, ME KOHË TË PJESSHME TË PROGRAMEVE TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” DHE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER
PROFESIONAL” TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007
“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin në universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, të formës së studimit me kohë të pjesshme, të programeve të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” në:

- a) Administrim biznesi;
- b) Menaxhim turizmi;
- c) Drejtësi.

2. Miratimin në universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, të formës së studimit me kohë të pjesshme, të programit të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në “Administrimin publik”.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe programi i studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, të pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri, të fillojnë në vitin akademik 2012-2013.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS
Myqerem Tafaj